



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1711/ 11 prot.

Datë 31.07.2026

V E N D I M

Nr. 896 /2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Gjergj Mersini	Nënkryetar
Donika Daci	Anëtar
Nertil Kanina	Anëtar

Në mbledhjen e datës 31.07.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.856/2026, datë 24.06.2026 për procedurën e prokurimit, “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” Mallra, me Nr. REF-83122-04-23-2026, me objekt “Blerje Kancelari” me fond limit 1,834,527.⁴⁹ Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 11.05.2026 nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve Tiranë.

Ankimues: Operatori ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” ShPK me NIPT K81503063B, Adresa: Rr. “Faik Konica”, ndërtesa nr.3, hyrja nr.7, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve Tiranë.
Adresa: Rr. “Barrikadave”, Tiranë.

Subjekte të Interesuara: Operatori ekonomik “Marketing & Distribution” ShPK, me NIPT J72124001N dhe adresë: Autostrada Tiranë–Durrës, Km. 10, Rr. Iliria, nr. 53, Kashar, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Me vendimin Nr.856/2026, datë 24.06.2026, Komisioni i Prokurimit Publik vendosi:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” ShPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” Mallra, me Nr. REF-83122-04-23-2026, me objekt “Blerje Kancelari” me fond limit 1,834,527.⁴⁹ Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 11.05.2026 nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor të shfuqizojë Vendimin e KVO-së dhe të rivlerësojë ofertat në përputhje me konstatimet e këtij vendimi.
3. Ngarkohet zyra e financës që të kthejë tarifën financiare të paguar nga operatori ekonomik IT Gjergji Kompjuter” ShPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Administrativ, Tiranë.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 874/11 prot., datë 06.07.2026, protokolluar me tonën nr. 1711/8 prot., datë 08.07.2026, autoriteti kontraktor njofton se, në zbatim të vendimit të KPP-së ka kryer rivlersimin dhe ka pasqyruar ndryshimet përkatëse për procedurën objekt ankimi si dhe ka bashkangjitur pamje nga sistemi, për procedurën e prokurimit me objekt shqyrtimi.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën nr. 874/11 prot., datë 06.07.2026, protokolluar me tonën nr. 1711/8 prot., datë 08.07.2026, autoriteti kontraktor, njofton se në zbatim të vendimit të KPP-së ka kryer rivlersimin dhe ka pasqyruar ndryshimet përkatëse për procedurën objekt ankimi për procedurën e prokurimit me objekt shqyrtimi.

II.2. Referuar shkresës sipërcituar dhe nga verifikimi i raportit të auditit për rivlersimin e ofertave të paraqitura, Komisioni kreu verifikimet dhe konstatoi, se Autoriteti Kontraktor ka kryer rivlerësim të procedurës së prokurimit më datë 03.07.2026 sipas konstatimeve të Vendimit të KPP-së.

II.3. Për sa më sipër konstatuar Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se Autoritetit Kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve Tiranë, ka zbatuar vendimin Nr.856/2026, datë 24.06.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar” Mallra, me Nr. REF-83122-04-23-2026, me objekt “Blerje Kancelari” me fond limit 1,834,527.⁴⁹ Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 11.05.2026 nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve Tiranë.

2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Donika Daci

Anëtar
Nertil Kanina

Nënkryetar
Gjergj Mersini